

## AKTI I THEMELIT I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR ARKEY DESIGN SHPK

Sot, më datë 23.10.2023 (dymijë e njëzet e tre), ortaku themelues:

**Z. Florid Virjoni**, i biri i Muhamet dhe i Flora i lindur në Durrës dhe banues në, adresën Njësia Administrative Nr.13, Rr,” Dibranëve,” Nd.13, H.1, Ap.14, Sauk Farkë, 1044,Tiranë madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me Nr. Letër njoftimit 036157370 Nr. Personal I90205078A.

I cili bën këtë akt themelimi të shoqërisë tregtare ARKEY DESIGN SHPK me termat e mëposhtme:

### NENI 1

Të themelojnë shoqërinë tregtare ARKEY DESIGN SHPK, në formën e një shoqërie me përgjegjësi të kufizuar. Në të gjitha aktet që do të nxjerrë shoqëria kundrejtuar të tretëve si dhe në të gjitha aktet e brendshme të saj, do të shënohet detyrimisht emri ARKEY DESIGN SHPK , sipas përcaktimeve të bëra në këtë Akt Themelimi dhe Statut.

### NENI 2

#### QËLLIMI I KRIJIMIT TË SHOQËRISË

Shoqëria do të kryejë aktivitetin sajë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë si mëposhtë:

Dizenjimi i produkteve të mobilimit të ambjenteve të brendëshme e të jashtëme të objekteve të banimit, socio kulturore dhe industriale. Tregtimi i produkteve që i përkasin fushës së arredimit të brendshëm si, materiale ndërtimi, materiale elektrike, materiale hidrosanitare etj. Ndërmjetsimin me palë të treta të punimeve të zbatimit, si punime elektrike, hidrosanitare etj të objekteve të banimit, social kulturore dhe industrial. Ofrimin e hapësirave ekspozuese, për produktet e dizenuara nga vetë kompania dhe palë të treta. Tregtimi i produkteve imobiliare të dizenuara nga kompania apo palë të treta.

### NENI 3

#### EMRI DHE VULA E SHOQËRISË

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin ARKEY DESIGN SHPK, e cila do të ketë edhe vulën e saj.

### NENI 4

#### SELIA E SHOQËRISË DHE AFATI

**5.1** Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën Njësia Administrative Nr.7, Rr,”Andrea Kushi”, Pasuria me Nr. 1/604, ZK 8210 Tiranë,

**5.2** Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar, duke filluar nga dita e regjistrimit të saj në Regjistrin Tregtar pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

### NENI 5

#### KAPITALI I SHOQËRISË

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi në para i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie.

Kapitali i shoqërisë është në vlerën 100.000 (njëqindmijë) lekë, e ndarë në 1 (një) kuotë me vlerë nominale të një kuote prej 100.000 (njëqindmijë) lekë.

Ortaku themelues i Shoqërisë Tregtare ARKEY DESIGN SHPK, zotëron kuotat në këtë shoqëri si më poshtë:

**Z. Florid VIRJONI, zotëron 100%**, të vlerës së kuotave në kapitalin fillestar të Shoqërisë të barabartë me 1 kuotë me vlerë nominale 100.000 (njëqindmijë) lekë.

## NENI 6 ORGANET DREJTUESE

Bazuar në ligjin nr. 9901, datë 14/04/2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare”, i ndryshuar organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

- I. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve – organi më i lartë vendimarrës;
- II. Administratori – organi ekzekutiv dhe administrativ i shoqërisë.

## NENI 7 ADMINISTRATORI DHE KUFIZIMET

7.1 Shoqëria administrohet nga ana e Administratorit i cili zgjidhet për një mandat pesë vjeçar me të drejtë rizgjedhje. Administratorët e shoqërisë do të jenë:

- **Z. Florid Virjoni**, i biri i Muhamet dhe i Flora i lindur në Durrës dhe banues në, adresën Njësia Administrative Nr.13, Rr,” Dibranëve,” Nd.13, H.1, Ap.14, Sauk Farkë, 1044,Tiranë madhor me zotësi të plotë për të vepruar, me Nr. Letër njoftimit 036157370 Nr. Personal I90205078A.
- Administratori Florid Muhamet Virjoni ka të drejta të plota për kryerjen e veprimeve të transaksionit të tërheqjes kesh apo të transfertave të parave dhe likujdimeve të faturave apo çdo vbeprimi tjetër ndaj të tretëve që janë subjekte juridike apo fizike private lidhur me numrin ellogaris që do të hapet pranë bankave. Ka të drejtë të kryej në çdo veprim lidhur me pagesat që rrjedhin nga detyrimi për pagimin e taksave vendore taksave qëndrore, gjobave lidhur me këto taksa, sigurimeve shoqërore e shëndetsore, rinovimin e liçencave të shoqërisë apo çdo veprim që lidhet me mandat pagesat, të lëshuara nga Organet dhe institucionet shtetore dhe kalimin e pagave të punonjësve. Të drejtat dhe kufizimet e mësipërme me llogarit bankare, do të vlejnjë edhe për llogarit bankare që do të hapen në të ardhmen nga shoqëria.
- Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratori e cili ushtron këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

## NENI 8

Ortaku themelues mund të vendosin me vullnetin e tyre për pjesmarrjen në Shoqëri të tjera dhe të krijojnë çdo lloj aktiviteti tjetër privat, me përjashtim të kufizimeve të përcaktuara me ligj.

## NENI 9

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e selive, degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe statutit.

## NENI 10

Ortaku/ët Administratori/ët, dhe punonjësit detyrohet të ruajnë sekretin e themelimit dhe të veprimtarisë së Shoqërisë. Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

## NENI 11

Mosmarrveshjet për themelimin e shoqërisë zgjidhen nga ortakët themelues dhe kur kjo nuk arrihet, ato zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

**ORTAKU  
FLORID MUHAMET VIRJONI**

